



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:009646  
Datë: 19.04.2024  
Numri i dokumentit: 05593631

**PAKR.nr.143/2024**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku, dhe Kadrije Goga Lubishtani, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Ardiana Morina, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh.L., nga fshati Bardhosh, Komuna e Prishtinës, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 173 par.1 nën par.1.3 lidhur me nenin 28 të KPK, duke vendosur sipas ankesave, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe mbrojtësit së të akuzuarit Sh.L., av.Florim Shefqeti, të ushtruara kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.4/2024, të dt.06.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.12.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohen** si të pabazuara ankesat, e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe mbrojtësit së të akuzuarit Sh.L., av.Florim Shefqeti, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.4/2024, të dt.06.02.2024, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.4/2024, të dt.06.02.2024, është shpallur fajtor i akuzuari Sh.L., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 173 par.1 nën par.1.3 lidhur me nenin 28 të KPK, ashtu që të njëjtit i është shqiptuar dënimi me burgim, në kohëzgjatje prej 5(pesë) viteve. Në dënimin e shqiptuar me burgim i është llogaritur koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga

dt.05.02.2024, gjersa të përfundon dënim i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, por jo më shumë sesa i njëjti.

Është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale, në shumën prej 50 Euro, në emër të ekspertizës mjeko ligjore, shumën prej 20 Euro, në emër të ekspertizës psikiatrike, shumën prej 270 Euro, si dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 50 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kërkesë pasurore juridike në këtë çështje penale nuk ka pasur.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

-Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.4/2024, i dt.06.02.2024, të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër, dhe

-mbrojtësi i të akuzuarit Sh.L., av.Florim Shefqeti, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, dhe shkeljeve procedurale, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.4/2024, i dt.06.02.2024, të anulohet dhe çështja penale ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje, apo që i njëjti të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i butë, me të cilin do të arrihet efekti dhe qëllim i dënimit.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.143/2024, të datës 08.03.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar, nga ana e Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, ashtu që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të akuzuarit Sh.L., ti shqiptohet dënim më i ashpër, kurse sa i përket ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit Sh.L., av.Florim Shefqeti, e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.12.04.2024, dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit ka prezantuar i akuzuari Sh.L., mbrojtësi i të akuzuarit, av.Florim Shefqeti, ndërsa nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit, si dhe i dëmtuari A.L., përkundër asaj që janë njoftuar në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.L., av.Florim Shefqeti, ka deklarua se ngel në tërësi pranë ankesës së ushtruar me shkrim, ka kërkuar që të mbrojturit të tij, ti shqiptohet dënim sa më i butë, dhe atë bazuar në dokumentacionin mjekësor, duke propozuar se i njëjti ka nevojë për trajtim, dhe se të vërtetohet pa aftësia e tij mendore, para kryerjes së veprës penale. Këtë rrethanë gjykata e shkallës së parë, nuk e ka pasur parasysh me rastin e marrjes së vendimit për dënimin.

I akuzuari Sh.L., ka deklaruar se e përkrah në tërësi ankesën e mbrojtësit, si dhe paraqitjen e tij në seancë të kolegjit.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesat e ushtruara, nga ana e Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, si dhe e mbrojtësit së të akuzuarit Sh.L., av.Florim Shefqeti, aktgjykimi të ankimuar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

**Ankesat, e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, si dhe e mbrojtësit së të akuzuarit Sh.L., av.Florim Shefqeti, nuk janë të bazuara**

Përkundër asaj që mbrojtësi i të akuzuarit Sh.L., av.Florim Shefqeti, nga ankesa pretendon se aktgjykimi përfshihet edhe me shkeljet procedurale, kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar të njëjtin si dhe të gjitha shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet procedurale, të cilat ndërlidhen me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, në kuptim të nenit 384 të KPPK, për të cilat shkelje kolegji i Gjykatës së Apelit, përkujdeset në pajtim të nenit 394 të KPPK. Ka ardhur në përfundim se me aktgjykimin e ankimuar nuk janë bërë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, si dhe shkeljet e ligjit penal, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke theksua se në këtë çështje penale nga ana e gjykatës së shkallës së parë, është shpallur fajtor i akuzuari Sh.L., për shkak të veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë, nga neni 173 par.1 nën par.1.3 lidhur me nenin 28 të KPK, dhe pasi që e ka shpallur fajtor të akuzuarin, i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5(pesë)viteve, jemi të bindur se dënimi nuk është adekuat i përgjegjësisë penale juridike të akuzuarit, për veprën penale të kryer, andaj propozojnë që të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.4/2024, të dt.06.02.2024 dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër.

Po ashtu anesë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, ka ushtruar edhe mbrojtësi i të akuzuarit Sh.L., av.Florim Shefqeti, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë, me rastin e marrjes së vendimit për dënimin nuk e ka vlerësuar në masë të duhur shkallën e përgjegjësisë penale juridike të akuzuarit, ndërlidhur me dokumentacionin mjekësor dhe konstatimet psikiatrike që kanë konstatuar që gjendja shëndetësore e të akuzuarit nuk është në rregull, e po ashtu edhe rrethanën që i akuzuari nuk ka qenë më parë i dënuar për asnjë veprë penale. Gjykata e shkallës së parë, është dashur që të vlerësoj se në veprimet e të akuzuarit pasi që është kryer vepra penale ti shqiptohet një dënim më i butë, duke vlerësuar rrethanat posaçërisht lehtësuese të parapara në nenin 70 par.3 përkatësisht 70 par.3.3, 3.6, 3.8, 3.9, 3.10, 3.11 dhe 3.12, lidhur me nenin 71 par.1.3 të KPK, ashtu që me aplikimin për institutin e zbutjes së dënimit, ti shqiptohet dënim më i butë, apo duke iu referuar dokumentacionit mjekësor,

rezulton që i akuzuari Sh.L., është dashur të dërgohet në trajtim të detyrueshëm mjekësor. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë, ka ara në kundërshtim me parimet bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që nënkupton se menjëherë bie në kundërshtim me dispozitat e KPPK. Në këtë çështje penale është shkelur parimi i gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, nga neni 31 lidhur me par.1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, çka nënkupton se i njëjti nuk mbështetet në normat juridike konkrete. Duke vazhduar në vlerësim të shqiptimit për dënimin, jemi të mendimit se me këtë lloj dënimi nuk do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë në nenin 38 par.1 të KPPK, sepse nuk janë aprovuar propozimet e mbajtësit, përkitazi me gjendjen shëndetësore këtu të akuzuarit. Edhe pse është konstatuar në fletë lëshimin e dt.08.01.2022, me numër të protokollit nr.418 dhe dokumentacionit që Sh.L., është i prekur, dhe nuk është koshient për gjendjen mendore, prapë se prapë gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar këtë rrethanë andaj edhe vendimi për dënimin jemi të mendimit që është i rëndë, sepse ka pasur rrethanë lehtësuese të bollshme që ti shqiptohet një dënim më të butë. Në këtë çështje penale nuk është dashur që të vlerësoj rrethanat rënduese, posaçërisht pretendimit se i akuzuari është recidivist, por është dashur që të vlerësoj gjendjen e tij shëndetësore e posaçërisht rrethanat e tij lehtësuese, sikurse është kërkim falja, pendueshmëria e thellë për veprën penale të kryer, dhe me aplikimin e institutit të zbutjes së dënimit, të njëjtit ti shqiptoj një dënim sa më të butë, me të cilin do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sipas ankesës së prokurorisë, si dhe mbrojtësit së të akuzuarit Sh.L., av.Florim Shefqeti, përkitazi me vendimin lidhur me sanksionin penal, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë e cila rezulton nga shkresat e lëndës, nga se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe pasi që pranimi i fajësisë është bërë konformë dispozitave përkatëse ligjore. Gjykata e shkallës së parë me rastin marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të lartësisë dhe llojit të tij, ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPK, e posaçërisht ka pasur parasysh se i akuzuarit e ka pranuar fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, ashtu që janë plotësuar kushtet ligjore, për pranimin e fajësisë nga ana e gjykatës, pasi që i akuzuari e ka pranuar të njëjtën. Po ashtu duke u mbështetur në të gjitha provat nga shkresat e lëndës, sikurse provat personale po ashtu edhe ato materiale, rezulton se gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën për të gjitha propozimet e ngritura dhe ka ardhur në përfundim se nga mendimi i marrë nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës, me dt.10.07.2023, përkitazi me ekzaminimin psikiatrik të akuzuarit, është konstatuar se i akuzuari është në gjendje të marrë pjesë në seanca gjyqësore, ashtu që nuk ka pasur pengesë. Se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe në konsultim me mbrojtësit, e tij, duke pranuar fajësinë janë të konstatuar në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor, andaj gjykata e shkallës së parë të gjitha këto rrethana lehtësuese i ka pasur parasysh, sikurse edhe rrethanat rënduese, ku si rrethana rënduese ka shfletuar dosjen kriminale të të akuzuarit për dy vepra penale sipas aktgjykimeve P-12/2000, i plotfuqishëm me dt.08.02.2001 dhe P-2008/2006, i plotfuqishëm me dt.29.10.2019, si dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale, dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës, të cilat i ka vlerësuar gjatë

shqiptimit të vendimit për dënimin. Po ashtu gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar nenin 70, 71 lidhur me nenin 72 të KPK, përkitazi me rregullt e përgjithshëm për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit dhe atë par.3 të nenit 70, pikën 3.3, 3.6, 3.8, 3.9, 3.10, 3.11 dhe 3.12 të KPK, përkitazi me rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, të cilat janë përshkruar më lartë, moshën e të akuzuarit, bashkëpunimin e përgjithshëm të akuzuarit me gjykatën, pranimin e fajësisë lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë, se ka shpreh keqardhje dhe është penduar për veprën e kryer penale, si dhe sjelljet e tij, pas kryerjes së kësaj vepre penale duke vepruar lidhur me zbutjen e dënimeve, si dhe kufijtë e zbutjes së dënimeve, dhe kolegji është i bindur se nga ana e gjykatës së shkallës së parë i është shqiptuar dënim proporcional me veprën e kryer penale.

Nga ankesa e prokurorisë, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese, sikurse nuk ka gjetur as nga ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit, ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, andaj kolegji ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.143/2023, të datës 12.04.2024**

**Bashkëpunëtorja profesionale,**  
**Ardianë Morina**

**Anëtarët e kolegjit,**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit,**  
**Xhevdet Abazi**

**Kadrije Goga Lubishtani**